



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.11/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Fejzullah Rexhepi kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Gragjanska Inicijativa Gore (GIG), me seli në Dragash, paraqitur kundër subjektit politik Jedistvena Goranska Partija (JGP), për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para datës së caktuar për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa Anr.11/2019 e datës 19.09.2019 e subjektit politik Gragjanska Inicijativa Gore (GIG), me seli në Dragash.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 19.09.2019, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Gragjanska Inicijativa Gore (GIG), me seli në Dragash, me të cilën ka pretenduar se subjekti politik Jedistvena Goranska Partija (JGP), para fillimit të fushatës zgjedhore ka shpalosur material promovues zgjedhor në përmbajtjen e së cilit ka qenë emri dhe logoja e partisë, “Për ruajtjen e Goresë dhe bashkësisë gorane”; Bartësi i listës dhe numri i tij me numrat rendor të të gjithë kandidatëve; Numri i partisë – 123 (i tërhequr me short të mbajtur me 17.09.2019), fakte këto të cilat sipas parashtruesit të ankesës janë të postuara në web faqen zyrtare të facebook-ut të Adem Hodža, Hamza Balje,dhe 22 të tjerëve në orën 4 të datës 18.09.2019, veprime këto të cilat sipas palës ankuese promovojnë idetë e subjektit politik në fjalë me qëllim të marrjes së votave të votuesve në favor të kandidatëve të vetë, para fillimit të kampanjës zgjedhore e cila është përcaktuar me vendimin e KQZ me Nr.824-2019 të datës 27.08.2019 pika II paragrafi I dhe e cila është përcaktuar të zgjatë nga 25.09.2019 deri me datën 04.10.2019.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi një fragment me fotografi dhe të dhëna nga faqja zyrtare e facebook-ut të Adem Hodza, kandidat për deputet nga subjekti politik PG.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Sipas Nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periudha për fillimin e fushatës zgjedhore e përcaktuar nga KQZ-ja, për Zgjedhjet Parlamentare 2019 fillon nga data 25.09.2019 dhe zgjat deri më datën 04.10.2019, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 11/2019 më datën 22.09.2019.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.